



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2019:294044

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05297575

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve G.SH., , Q.V., Z.B., që të tre nga fshati ... Komuna e Gjakovës dhe N.R., nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova avokat në Gjakovë, kundër debitorës së përmbarimit Komunës së Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1039/19 të datës 08.06.2021, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, në shumën e përgjithshme prej 4,077.32 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 07 shkurt 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, 2019:294044 të datës 28.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1167/19, të datës 07.06.2021, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, dhe atë:

- kreditorës G.SH., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 546.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 117.51 euro,

- kreditorit Q.V., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 214.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 46.05 euro,

- kreditores Z.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 1,002.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 215.66 euro,

- kreditores N.R., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 361.80 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 77.30 euro,

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbartimore në shumën prej 1,497.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 4,077.32 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitorës së përmbartimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditoreve avokat Ilir Rogova LLC, në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr...., në Bankën Kombëtare Tregtare-BKT- Dega në Kosovë.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përmbartimit, me aktvendimin 2019:294044, të datës 28.03.2023, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 04.04.2023, ndërsa i autorizuari i kreditores me datë 12.04.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorës, gjykata me aktvendim 2019:294044, të datës 04.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse palët kreditore në propozimin e tyre për përmbartim, kanë cekur mjetin e përmbartimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, përkatësisht

kreditores G.SH., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 546.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 117.51 euro, kreditorit Q.V., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 214.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 46.05 euro, kreditores Z.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 1,002.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 215.66 euro, kreditores N.R., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 361.80 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 77.30 euro, t'ia paguaj përkatësisht shumën e përgjithshme prej 4,077.32 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, 2019:294044, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1167/19, të datës 07.06.2021, i plotfuqishëm me datë 12.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 02.02.2023, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbarimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditoreve të përmbarimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm-

2019:294044, më 07 shkurt 2024

Numri i lëndës: 2019:294044  
Datë: 07.02.2024  
Numri i dokumentit: 05297575

**GJYQTARI,**  
**Durim BALAJ**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.